



- Të Reja ▾
- Policia e Shtetit ▾
- Shërbime ▾
- Baza ligjore
- Vendndodhjet e policisë
- Video
- Programi i transparencës ▾
- Kontakt
- Denonco Krimin Kibernetik
- Drejtoritë Vendore të Policisë ▾
- Policia Kufitare ▾
- Policia Rrugore ▾
- Donacione
- Rubrika Policimi në Komunitet ▾



20/04/2022

Kamzë – Vijon operacioni policor i koduar “Filiali 2”, vihet në pranga autori kryesor i vjedhjes

Vijon operacioni policor i koduar “Filiali 2”, i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Nr. 5.

Kapet dhe vihet në pranga autori kryesor i vjedhjes së një shume parash, nën kërcënimin e një arme, në filialin e Postës Shqiptare.

Sekuestrohen 1 milion lekë të rinj, një aparat celular, një armë zjarri pistoletë dhe veshjet që autori dyshohet se i ka përdorur gjatë kryerjes së krimit.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 5, në Kamzë, në vijim të punës për goditjen e paligjshmërisë dhe kapjen e personave në kërkim, në vijim të veprimeve intensive hetimore, në bashkëpunim me Sektorin e Forcës së Posaçme Operacionale, bënë kapjen dhe arrestimin në flagrancë të shtetasit E. S., 30 vjeç, banues në Kamzë.

Më datë 18.04.2022, rreth orës 14:20, shtetasi E. S., në bashkëpunim me shtetasin A. K., 20 vjeç (i arrestuar më parë), nën kërcënimin e një arme, kanë marrë një shumë parash në filialin e postës Shqiptare në Kamzë.

Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar 1 milion lekë të rinj, një aparat celular, një armë zjarri pistoletë dhe veshjet që autori dyshohet se i ka përdorur gjatë kryerjes së krimit.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme.

- Share
- Share
- Share
- Share
- Email